



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME

Thirrja e dytë për Projekt Propozime

2018-03-28 16:21:00

Shpallet Thirrja e dytë për Projekt Propozime – Programi i Bashkëpunimit Transnacional INTERREG “ADRION 2014-2020”

Thirrja e dytë për Projekt Propozime e Programit të Bashkëpunimit Transnacional INTERREG V-B Adriatiko-Jonian “ADRION 2014-2020” u shpall më datë 26 Mars 2018. Buxheti në total i thirrjes është 34.354.026,50 Euro, nga të cilat 29.197.521,05 Euro janë fondet e ERDF dhe pjesa tjetër prej 5.156.505,45 Euro janë fonde IPA.

Afati për dorëzimin e projekt-propozimeve është data 26 Qershor 2018 ora 15:00 (CET)

Thirrja e 2të është shpallur për **Aksin Prioritar 2** të Programit :

Aksi Prioritar 2: Rajon i Qëndrueshëm

Ø **Objektivi specifik 2.1** – Nxitja e ruajtjes së qëndrueshmërisë dhe pasurive natyrore dhe kulturore

Ø **Objektivi Specifik 2.2** – Rritja e kapaciteteve transnacionale në ndërshtetërore në trajtimin e problemeve mjedisore, fragmentimi dhe ruajtja e shërbimeve të ekosistemit në zonën Adriatiko-Joniane.

Më shumë informacion në lidhje me Programin e Adrion INTERREG, kushtet për paraqitjen e projekt propozimeve, vlerësimin e propozimeve, paketa e aplikimit, si dhe informacione të tjera relevante janë në dispozicion në <http://www.adrioninterreg.eu/index.php/projects/second-call-for-proposals-priority-axis-2/>

Adresat e kontaktit në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEFA) të cilat do mund t'ju ofrojnë asistencë të nevojshme lidhur me këtë Thirrje për Projekte janë:

- Gentian Xhaxhiu – gentian.xhaxhiu@mfa.gov.al
- Elkana Himçi – elkana.himci@mfa.gov.al